



Komuna e Podujevës
Ministarstvo Pravde
Ministry of Justice

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPSTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 12.11.2025		
Nr. orig. Org. led.	Nr. Br.	Shtojcë Prilog
02-016/01-007-60/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		

Education
Empowerment
Initiative

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur në mes

- Komunës së Podujevës, e përfaqësuar nga Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

dhe

- Education Empowerment Initiative-EEI, me nr. Unik identifikues 603064461, me adresë Rr. Imzot Nike Prela D9 H2 Nr3 Ulpianë, Prishtinë, përfaqësuar nga znj. Blerta Aliu Ahmeti- në cilësinë e përfaqësueses së autorizuar.

(Në tekstin e mëtejshëm, së bashku referuar si : “ Palët”).

I. Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi është të vendoset bashkëpunimi ndërmjet Palëve për zbatimin e projektit “ **Edukimi Medial – Ekspertiza Nordike në Arsim**”, i financuar nga Këshilli i Ministrave Nordikë.

Ky projekt sjell ekspertizën nordike në sistemin arsimor të Kosovës me synim forcimin e edukimit medial, sigurisë digjitale dhe mendimi kritik tek mësimdhënësit dhe nxënësit.

Ndërmjet këtij bashkëpunimi, EEI dhe Komuna e Podujevës synojnë të promovojnë një qasje moderne, gjithëpërfshirëse dhe të sigurt në arsim, e cila i ndihmon mësimdhënësit dhe nxënësit të zhvillojnë aftësi për të lundruar me përgjegjësi në botën digjitale.

II. Fusha e bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

1. Trajnime dhe Ndërtim Kapacitetesh

Ekspertët Nordik do të zhvillojnë një program ToT (Training of Trainers) për ekipin lokal EEI –së me qëllim përgatitjen e tyre për trajnimin e mësimeve në shkollat e Podujevës. Pas përfundimit të programit ToT, trajnerët e certifikuar të EEI-së do të realizojnë sesione trajnime me 30-40 mësime në shkollat e përzgjedhura me fokus në :

- Edukim medial dhe analizë kritike të burimeve të informacionit;
- Siguri digjitale dhe sjellje të përgjegjshme në internet ;
- Parandalim të dezinformimit dhe përmbajtjeve të dëmshme online;

2. Mbështetje dhe Koordinim nga Komuna

Komuna e Podujevës ,përmes Drejtorisë së Arsimit do të :

- Lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin me shkollat pjesëmarrëse;
- Ndihmojë në identifikimin dhe përzgjedhjen e mësimeve që do të marrin pjesë;
- Mbështesë planifikimin e orareve dhe ofrimin e hapësirave shkollore për zhvillimin e aktiviteteve;
- Sigurojë mbështetje institucionale dhe logjistike sipas nevojës;

3. Shkëmbimi i informacionit dhe rezultatit

EEI do të ndajë me Komunën përditësime dhe raporte përmbledhëse mbi ecurinë dhe rezultatet e aktiviteteve të projektit.

Njëkohësisht EEI do të dorëzojë raportin përfundimtar tek donatori Partnerët Nordik në përputhje me udhëzimet e projektit.

4. Vizibiliteti

Të gjitha materialet, aktivitetet dhe komunikimet publike do të theksojnë **mbështetjen e Këshillit të Ministrave Nordikë** dhe do të evidentojnë **kontributin e ekspertizës nordike** në këtë projekt.

Mund të organizohen vizita në shkollat dhe aktivitete ndërgjegjëse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komunës dhe partnerëve nordikë për të forcuar transparencën dhe bashkëpunimin publik.

III. Kohëzgjatja dhe ndërprerja

Ky Memorandum mbetet në fuqi **tetëmbëdhjetë (18) muaj** nga data e nënshkrimit me mundësi ndryshimi dhe vazhdimi përmes marrëveshjes me shkrim të dy Palëve.

Secila palë mund të ndërpres këtë Memorandum duke e njoftuar me shkrim palën tjetër së paku tridhjetë (30) ditë përpara.

IV. Dispozitat përfundimtare

Ky Memorandum pasqyron mirëkuptimin dhe angazhimin e përbashkët të palëve për zbatimin me sukses të projektit.

Palët angazhohen të bashkëpunojnë me mirëbesim, transparencë dhe komunikim të vazhdueshëm, për të siguruar arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje eventuale palët do të kërkojnë zgjidhje përmes dialogut dhe bashkëpunimit konstruktiv, pa cenuar marrëdhëniet institucionale.

Memorandumi është përpiluar në (4) kopje identike, nga dy kopje për secilën palë nënshkruese.

V. Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Palët nënshkruese:

Komuna e Podujevës
Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës



Education Empowerment Initiative - EEI
Blerta Aliu



Podujevë, datë: 12/11/2025